

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.06.2024, ora 13:25 në ambjentet e qëndrës rimore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Mirëseerdhët në mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak. Ftoj sekretarin të bëj apelin.

Sekretari i këshillit bashkiak bën apelin. Marrin pjesë **40 anëtarë** të Këshillit Bashkiak.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.

Blendi Himçi – Anëtarë i Këshillit Bashkiak

Rendin e ditës e kemi por materialet jo.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kë materiale nuk keni Planin Vendor?

Blendi Himçi – Anëtarë i Këshillit Bashkiak

Planin vendor, materialin e UKE për rritjen e ujit.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ai material ka qënë dhe në mbledhjen e kaluar, e kemi diskutuar dhe në Komisione dhe materialet jua kemi dërguar me email. Ndërsa Plani Vendor, pasi ram të gjithë dakord dhe duke qënë material 300 faqe jua dërguam vetëm në email.

Doris Madhi – Anëtare e Këshillit Bashkiak

A janë pasqyruar ndryshimet që diskutuan në komision?

Erion Murataj – Anëtarë i Këshillit Bashkiak

Në vazhdën e këtyre diskutimeve, në mbledhjen e fundit të komisioneve kemi pasur dhe pikën e ujësjellës kanalizime, dhe Planin e Përgjithshëm Vendor, të cilën e sqaroi kryetari i bashkisë, sot shikoj pikë të rendit të ditës materialin e UKE, i cili nuk u diskutua në komisione. Shkeljen procedurale ti mund ta bësh, por ka një detyrim moral për ta trajtuar në komision dhe nuk e trajtovë fare.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

U trajtua ne komision. Pse duhet të thuash një gjë që nuk është e vërtetë, ti je marrë më shumë atë ditë me përfaqësuesit.

Aulona Bylykbashi – Nënkyetare e bashkisë

Ju u çuat ikët nuk e diskutuat. Kam qënë aty deri në fund.

Erion Murataj – Anëtarë i Këshillit Bashkiak

Je e sigurt, mbledhja është e regjistruar. Unë i kërkoj sekretariatit që për shkak të kësaj shkelje procedural që është bërë, kërkoj heqjen nga rendi i ditës së sotshme të pikës së ujësjellës kanalizime.

Aulona Bylykbashi – Nënkyetare e bashkisë

Janë bërë dy mbledhje komisionesh dhe material ii UKE është i ezauruar. Nuk është shkelje procedurale.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Jnaë bërë dy mbledhje komisionesh për këtë pikë. Në mbledhjen e parë kanë qënë përfaqësues të ujësjellësit, kemi bërë diksutim të përbashkët, kanë qënë dy përfaqësues të UKE. Tek mbledhja para një jave thash që do të ketë një mbledhje vazhdimësie, pra tek komisionet e kësaj mblehdje ti e diskutove këtë pikë, kjo nuk është mbledhje tjetër është mbledhje e vazhdimësisë së mbledhjen së kaluar.

Valbona Balliu - Anëtare e Këshillit Bashkiak

Atëherë ku e keni vendimin e komisionit?

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Megjithatë, edhe nëse një pikë nuk kalon në komision, do të diskutohet në mbledhjen e këshillit.

Erion Murataj – Anëtarë i Këshillit Bashkiak

Atëherë pse i mban komision? i shkrimi komisionet.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Erion është e shkruar në rregullore.

Valbona Balliu - Anëtare e Këshillit Bashkiak

Vendimin e komisionit duhet ta zbardhës ti zotëri.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Zonja këshilltare, komisioni e mban vet procesverbalin e mbledhjes, as unë as Elvi. Komisioni kur është krijuar ka kryetarin, zv/kryetarin dhe sekretarin e vet, dhe ata kanë të drejtë të m, bajnë procesverbalin, nuk mund tma kërkosh mua. Unë nuk jam fare pjes e mbledhjes së komisioneve.

Valbona Balliu - Anëtare e Këshillit Bashkiak

Procesverbalet i mban sekretariati.

Erion Murataj – Anëtarë i Këshillit Bashkiak

Këtë pikë ti nuk e kalon dot sot. Nuk kalon ujësjellësi sot, ke shkelur anën procedurale.

Pika e parë miratimi i rendit të ditës.

Këshilli Bashkiak me 26 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.06.2024, ora 13:25 në ambjentet e qëndrës rimore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e dytë e rendit të ditës - Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr.163 Datë 21.11.2020 “Për dhënien në përdorim me kontratë qeraje të fondit pyjor publik” dhe VKB Nr.124 Datë 26.09.2022 “Për dhënien në përdorim me kontratë qeraje të fondit pyjor publik”

Ftoj Z. Shpëtim Cullhaj të relatojë.

Altin Meçja -Anëtarë i Këshillit Bashkiak

Relaton kryetari i komisionit jo drejtori.

Indrit Abdiaj -Anëtarë i Këshillit Bashkiak

Kur nuk është drejtori ne themi ku janë duam informacione më të holllësishme. Tani që na vjen drejtori kërkojmë kryetarin e komisionit. Gjithsesi, propozimi është bërë për vendosjen e paneleve fotovoltaike, siç kemi diskutuar dhe herë tjetër janë investime efikase, dhe këtë herë në jemi dakord.

Blendi Himçi – Anëtarë i Këshillit Bashkiak

Z. Lala, mënyra se si po veprohet është në shkelje procedurale, çdo gjw po bëhet shpejt. Kemi përgjegjesi me mandatin që na ka dhënë populli. Do japim edhe llogari, por dhe administrata të vi të japi llogari. Këshilli nuk është zgjatim i administratës, është organi vendimarrës. Mënyra se si po veproni në mungesë të materialit dhe mbledhjes live, mënyrës si i kapërceni procedurat, ne nuk do jemi pjesë si grup këshilltarësh BF, për të vazduar këtë mbledhje. Mos harrojmë që ndryshimi i planit rregullues edhe siç e diskutuam në mbledhjen e këshillit bashkiak dhe që ramë dakord por material nuk ka, dhe ne nuk kemi si ngrem dorën për elemetë që nuk i dimw. Kemi qënë në parim dakord në komision, por sot duhet të kishte material. Kështu që ne largohemi, për të qënë ju më të përgjegjshëm në mbledhjen tjetër.

Grupi i BF largohen nga mbledhja B. Himçi, D. Madhi, V. Balliu, R. Mita, D. Cepa, A. murati, A. Kana, E. Muzhaqi, M. Trimë.

Erion Murataj – Anëtarë i Këshillit Bashkiak

Z. Lala në mbledhjen e komisionit ke çuar njoftim duke thënë se rend dite të komisionit do të shqyrtohesin çështjet e ujësjellës kanalizime. Unë jam nga ata që fjalën që them i qëndroj deri në fund. Si svarove pjesën e PPV, dhe që jam shumë dakord me zhvillimin e qytetit, ashtu siç kam kushtëzuar do ta kushtëzoj prap, dhënien e ujësjellës kanalizime sot, dhe mos rritjen e tarifës për qytetarët, po them që kjo është mbledhja e fundit që ti zhvillon në kushte normale pa praninë e qytetarëve jashtë dyerive në rast se vendos ti shtosh me kokëfortësi barrën që do mbajn qytetarët në kuirriz me tarifën. Është institucion ku ju jeni bashkëkryetar, ku keqmenaxhimi është i juaji dhe mënyrës politikë bërëse.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ne kemi çështjen e dhënies nëpërdorim të pyjeve dhe ti ngre çështjen që të intereson.

Erion Murataj – Anëtarë i Këshillit Bashkiak

Më intereson mua dhe qytetarëve.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Jemi tek pika 3 e cila është gjithashtu në interest ë qytetarëve.

Erion Murataj – Anëtarë i Këshillit Bashkiak

Nuk doja të diskutoja për këtë por meqë e përmende interesin e qytetarëve. Ti po jep një tokë me qera sot, por që e ke dhënë me qera ku për interesa të dissave po jep një tokë që ka qënë object dhe ti po e kalon pa psur një studim në ndikim në mjedis, është e drejta jote ta japësh, por kjo mbledhje nuk ka rëndësi për këto mbledhje. Sot pika fryesore është tarifa e UKE. Hiq nga rendi i ditës rritjen e tarikafe të UKE. Ëstë në nderin tënd. Qytetarët e Elbasanit kush e quan veten të majtë këtu nuk duhet tacoj në mendjen të rrisi tarifën e ujësjellës kanalizime. Po të bëj thirrje për herë të fundit nëse do rrjedhshmëri normale të mbledhjes hiq nga rendi i ditës tarifën e UKE.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Rendi i ditës u miratua. Mund ta lexosh nenin 30 të rregullores.

Eugen Isaj – Anëtarë i Këshillit Bashkiak

I nderuar kryetar, në rradhë të parë më vjen keq për këto debate nuk duhet të shkojnë, keqardhja është diku tjetër. Atë që ngritëm në Nëntor dhe Dhjetor, dhe që ia kërkuan dhe këshilltarëve të majtë mos e votonin ishin tarifat vendore. Sot faturat kanë shkuar tek bizneset dhe ate që tham ne ishte e vërtetë. Sot faturat e biznesit janë rritur 50%-70%. Mund të thoni nuk është e vërtetë por secili nga këshilltarët njeh dhe komunikon me një biznes, ti pyesin sa ka shkuar ajo që keni çuar dhe do shiu koni është ëshët aq. Ju mund të kapni raste t'veçanta që nuk është e vërtetë. Kjo më trishton që biznesit i janë rritr taksat kaq. Vim ktu dhe bëjmë për rendin e ditës, komisionet e dim si funksionojnë. Ujësjellësi sigurisht që është temë që duhet te diskutohet. Unë takova pak më parë drejtorin, dhe siigurisht që edhe ai është në siklet të madh ti rrisi çmimin e ujit familjeve, dhe ai e di këtë gjë por duhet gjetur një zgjidhje, ne do japim opinion atë e vendsos dikush tjetër. Dhe ajo ndërmarrje ka nevojë për të ardhura. Nuk kemi pse bëjmë debate, ulemi diskutojmë për të mirën e qytetarëve. Në gjykimin tim nuk duhet, i kemi ngrit tarifat bizneseve tani vjen rradha famamiljeve. Por duhet dëgjuar dhe institucioni, a ka bërë reform, unë e di që ka bërë reform, por nuk është kjo zgjidhja. Zgjidhja është subvencion i nga qeveria, nuk është zgjidhje rritja e tarifave. Gjë tjetër ne presim bashkëpunim me cdo një nga ju, unë bojkotin se kam pas kurrë primare, të ulemi të diskutojmë ti dëgjojmë të gjithë. Mua me vjen keq nuk dëgjoj një nga kolegët e majtë asnjë nuk flet. Jemi këshill bashkiak do flasim diskutojmë për të mirën e qytetarëve te mendojmë kush është më e mira si për institucionet dhe për qytetarët.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Falemiderit Z. Eugen, doja të shtoja diçka, që në ditën që kam marr detyrën asnjë material nuk ka ngelur pa u paraqitur në komision, ka qënë apo jo kuorumi kjo është gjë tjetër.

Altin Meçja – Anëtarë i Këshillit Bashkiak

Nuk mund të bëhem unë kuorum për të mbajtur kuorumin këtu. Keni marr njerëzit që keni në punë.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Altin edhe ti e more ditën e punës e shënove emrin.

Altin Meçja – Anëtarë i Këshillit Bashkiak

Z. Lala jam i vetmi njeriqë nuk i ka borxhe në këtëqytet askujt. Unë jam mësues edhe doctor sahkencash nëse do ta dish.

Grupi i PD E. Isaj, M. Kaçuli, B. Çopja, A. Meçja dhe këshilltari Erion Murataj largohen nga mbledhja.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan


Është e rëndësishme të theksojm që kur filloj mbloedhja ishin 40 anëtarë. Rëndësi ka që mbledhja vazhdon janë të pranishëm 26 këshilltarë.

Pika e dytë e rendit të ditës - Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr.163 Datë 21.11.2020 “Për dhënien në përdorim me kontratë qeraje të fondit pyjor publik” dhe VKB Nr.124 Datë 26.09.2022 “Për dhënien në përdorim me kontratë qeraje të fondit pyjor publik.”

Mungesë kuorumi nuk kalon ngelet për mbledhjen e ardhshme.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.06.2024, ora 13:25 në ambjentet e qëndrës rimore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtore nga administrata e bashkisë, media.


Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e tretë e rendit të ditës- Mbi dhënie në përdorim pa kundërshpërbirim, (rinovim kontrate) të disa ambjenteve të ish konviktit të Shkollës “Onufri”, Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a nga Bashkia Elbasan.

Mungesë kuorumi nuk kalon ngelet për mbledhjen e ardhshme.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elyi Çuni



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.06.2024, ora 13:25 në ambjentet e qëndrës rimore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtore nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e katërt e rendit të ditës - Marrje mendimi nga Këshilli Bashkiak për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm.


Këtë pikë mund ta diskutojme sepse kërkon shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit, jemi prezent 26 anëtarë.

Këshilli bashkiak me 26 vota pro, - kundër, - abstenim miraton sa më sipër.


Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga


Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni


Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala


PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.06.2024, ora 13:25 në ambjentet e qëndrës rimore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e pestë e rendit të ditës - Për miratim në parim të dhënies së pëlqimit për shfrytëzimin e pronave shtetërore në Njësinë Administrative Gjinor.

Mungesë kuorumi nuk kalon ngelet për mbledhjen e ardhshme.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga




Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.06.2024, ora 13:25 në ambjentet e qëndrës rimore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtore nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e gjashtë e rendit të ditës - Ndërmarrja e nismës për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, me procedurë të thjeshtuar.

Ilirjan Sadiku – Anëtarë i Këshillit Bashkiak

Në mbledhjen e komisionit u dakortësua, pavarësisht e sot ka mungesa unë them ta miratojmë. Shikoje rregulloren a lejohet pranohet.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Nisma merret me shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit, e kemi shumicën e thjeshtë, por po pyes nëse ka pyetje apo diskutime nëse doni sqarime. Përveç nesh si grup në komision ishim të gjithë dakord të gjithë grupet sepse ka të bëjë me fjalën nisëm, kemi të bëjmë më një fazë që do të diskutohet përsëri në fazën tjetër, por ne japim dritën jeshile.

Ali Mysliu- Anëtarë i Këshillit Bashkiak

Jemi 25 veta. Nuk mbaj përsipër të bëjmë diçka që nuk bëhet.

Eva Bica - Anëtarë i Këshillit Bashkiak

Jemi 26 bashkë me Lutfiun.

Këshilli Bashkiak me 26 vota pro, - kundër, - abtenim miraton sa më sipër.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Janë tre pika të cilat për mungesë kuorumi do të shqyrtohen mbledhjen tjetër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

